



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:196908

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855482

PPP. nr. 212/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të Kreditorit A.G nga Komuna Gllogoc, kundër debitorit B.G nga Komuna e Gllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej 949.00 €, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat H.H P. nr... të datës 26.08.2020, jashtë seancës me datën 30.10.2023 gjykata e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit B.G nga Komuna e Gllogocit, ushtruar kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat H.H P. nr... të datës 26.08.2020 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit për përmbartimin e borxhit në shumën prej 949.00 €, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat H.H, P. nr... i datës 26.08.2020 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat H.H, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktvendimit C. nr. 601/2020 i cili është i plotfuqishëm, i cili sipas Nenit 4, 10, 22 pika 1.2, 24 par. 3 dhe Nenit 38 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të Nenit 24 par. 1 të këtij ligji është dokument i përmbartueshëm.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit në afat ligjor debitori ka paraqit prapësim, me arsyetimin se: *propozimi për përmbartim si i tillë bazohet në Aktvendimin me nr. C. nr. 601/2020 me të cilin është aprovuar padia e paditësit A.G, ku e obligon debitorin që kreditorit t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale në shumën prej 949 € në afatin prej 7 ditësh, por i njëjti pretendon se i njëjti nuk ka pranuar asnjë vendim nga Gjykata dhe rrjedhimisht nuk i ka shfrytëzuar mjete juridike, debitorit pasi që nuk ka pranuar Aktvendimin C. nr. 601/2020 i është pamundësuar ushtrimi i mjetit juridik në këtë rast, mirëpo me datën 28.08.2020 debitori ka*

pranuar urdhërin përbarimor me të cilin ka qenë i bashkangjitur edhe Aktvendimi C. nr. 601/2020, andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e tij si të bazuar.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke e kundërshtuar në tërësi në të gjitha pikat si të pa bazuar prapësimin e paraqitur nga debitori me arsyetimin se: *pretendimet e debitorit janë shumë jo relevante sa i përket momentit të procedurës, procedura përbarimore paraqet një procedurë rigorozë formale, ku ofrohet mbrojtje direkte e ku të gjitha shkaqet e prapësimit janë të paraparë në mënyrë taksative në Nenin 71 të LPP-së, dhe sa i përket asaj se a e ka pranuar me rregull apo jo aktvendimin dokument përbarues sipas kësaj procedure konsiderojmë se kjo çështje faktike nuk mund të jetë subjekt i kësaj procedure, lënda ndodhet në gjykatë dhe zyrtarët përgjegjës nuk do të kishin mundur të bënin të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm vendimin, ndërsa sa i përket kundërshtimeve tjera që do të mund të bëheshin përshtatshmerisë së dokumentit për përbarim e në rastin konkret aktvendimi objekt i kësaj çështje përbarimore, në kuptim të Nenit 27 të LPP-së i ka plotësuar të gjitha kushtet që të jetë i përshtatshëm për përbarim, gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit si dhe të vërtetohet urdhëri përbarimor P. nr... i datës 26.08.2020.*

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 04.09.2020 është i pabazuar, pasi që, me faktin se Aktvendimi C. nr. 601/2020 është i plotëfuqishëm që nga data 17.08.2020 që ka të bëj me objekt kontesti Pengim Posedimi, ku Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc përveç tjerash në piken e IV të dispozitivit e ka obliguar tani debitorin që të ia kompensoj kreditorit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 949 €. Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet e tjera të debitorit se i njëjti nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e mjetit juridik pasi që nuk ka pranuar vendim nga gjykata, por gjykata konstaton se debitori ka qenë në njohuri për kontestin dhe rastin në fjalë pasi që ka qenë i ftuar që të marr pjesë në seancë mirëpo i njëjti nuk i është përgjigjur dhe nuk e ka respektuar, gjithashtu kemi të bëjmë me një Aktvendim të plotëfuqishëm i cili tanimë është bërë i përbarueshëm që nga data 07.08.2020 dhe si i tillë duhet të ekzekutohet.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 20, 21 dhe 22 par.1 pika 1.1 pasi që vendimi gjyqësor është dokument i përbarues, ndërsa sipas Nenit 23 par. 1 të LPP-së “*vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi dhe aktvendimi (i gjykatës), si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit*”, dhe sipas Nenit 24 par. 1 të LPP-së “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshem po që se ka marrë formë të prerë....*”.

Pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të gjykatës (Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc të datës 15.07.2020), i plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 17.08.2020 me të cilin debitori është obliguar që të ia kompensoj kreditorit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 949 € e të cekura si në dispozitiv të aktvendimit gjyqësor, andaj gjykata vendosi që të refuzoj prapësimin e debitorit si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që vendimi gjyqësor-Aktvendimi i datës 15.07.2020 është dokument përbarues.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par. 3 të LPP-së kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc

Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 212/22 i datës 30.10.2023

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.